



REPUBLICA E KOSOVES - RIKONSTRUKCIONE  
KOMUNA E VUSHTRIS - KOSOVA

Udhëzimi Nr. 25/23

Shifri i shtetit -1-

Data e miratimit 31.01.2023



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**


Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në shkresën zyrtare të MAPL-së me numër reference Nr:VI-020-992/5 e datës 2.12.2022, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: **31 janar 2023** merr këtë:

### **VENDIM**

**për shfuqizimin e vendimit me nr. 265/22 i datës 27.10.2022**

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 265/22 i datës 27.10.2022, lidhur me caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0, në sipërfaqe prej 613 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 m<sup>2</sup>, me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.**
2. Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke marrë për bazë vlerësimin e ligjshmërisë të aktit në fjalë, të bërë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i propozon Kuvendit të komunës shfuqizimin e aktit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesja e kuvendit, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

  
**Kryesuese e Kuvendit**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPSTINA VUČITRA

01 Nr. / Br. 26/23

Nr. Liq. / Br. liq. -1-

Data / Datum 31. 01. 2023

VUSHTRISË - VUČITRA



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**


Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në shkresën zyrtare të MAPL-së me numër reference nr:VI-020-1081/5 e datës 27.12.2022, për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: **31 janar 2023** merr këtë:

**VENDIM**

**për shfuqizimin e vendimit me nr. 294/22 i datës 24.11.2022**

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 294/22 i datës 24.11.2022, lidhur me caktimin e lokacionit** për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0, në sipërfaqe prej 613 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 89886 m<sup>2</sup>, me kulturë kullosë e kl.4 ZK - Pasomë, e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke marrë për bazë vlerësimin e ligjshmërisë të aktit në fjalë, të bërë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i propozon Kuvendit të komunës shfuqizimin e aktit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesja e kuvendit, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

  
**Kryesuese e Kuvendit**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

01 No./De: 27/23

02 No./De: -1-

03 Data/Date: 31.01.2023



## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në shkresën zyrtare (opinionin) e Agjencisë Kundër Korrupsionit me numër reference nr:AKK-DPKI-06-1655/21 i datës 24.03.2022, lidhur me trajtimin e rastit të konfliktit të interesit në nxjerrjen e aktit, po ashtu duke marrë për bazë përgjigjen në kërkesë me numër të referencës Nr.020-363/10 e datës 01.11.2022 të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me vendimin Nr.81/21 i datës 16.04.2021, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë: **31 janar 2023** merr këtë:

### VENDIM

#### për shfuqizimin e vendimit me nr.81/21 i datës 16.04.2021

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 81/21 i datës 16.04.2021, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh** bizneseve private, nga parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihatë Basholli-Latifi

Kryesuesë e Kuvendit

